



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	17.01.2025
REFERENC-Ë:	24/6507/ MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Graniti & Co", Sh.p.k., Suharekë Fabrikë për prodhimin e Styroporit, Shirokë, Suharekë.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.Đ. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për vazhdimin e Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për vazhdimin e Lejes Mjedisore të operatorit, "Graniti & Co", Sh.p.k., me nr. prot. 24/6507/MMPHI, Suharekë për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e Styroporit, Shirokë, Suharekë.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 23/6507/MMPHI
Datë: 17.01.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatorit "Graniti & Co" Sh.p.k. Suharekë, i vazhdohet Leja Mjedisore, sipas kërkesës me nr. prot. 24/6507/MMPHI, për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e Styroporit, në ngastrat nr. P-72116046-02785-15 dhe P- 72116046-02785-16, zona kadastrale, Shirokë, K. Suharekë.
2. Operatori obligohet:
 - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
 - 2.2. Të mirëmbahen kolektorët e ujërave atmosferik, që përcillen nga sipërfaqja operimit në basenin sedimentues;
 - 2.3. Mbetjet nga procesi teknologjik, të vendosen në hapësirë të betonuar dhe izoluar, ose të vendosen në kontejner të mbyllur;
 - 2.4. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit të mjedisit që është përgjegjës për mjedis;



- 2.5. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore, fakteve të grumbulluara në teren, është konstatuar se operatori, "Graniti & Co" Sh.p.k. Suharekë, me nr. prot. 24/6507/MMPHI i plotëson kushtet për vazhdimin e Lejes Mjedisore për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e Styroporit, Shirokë, Suharekë.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrit të biznesit;
- Leje Ndërtimore me 07 Nr.664/350-358;
- Pëlqim Mjedisor me Nr.17/353/2-DMM-ZSP/98/17, të lëshuar me datë: 11.04.2017;
- Leje Ujore për shfrytëzim Nr.5908/21-ZSP-2021, të lëshuar me datë: 30.12.2021;
- Leje Ujore për shkarkim Nr.5909/21-ZSP-2021, të lëshuar me datë: 30.12.2021;
- Leje Mjedisore me Nr. 19/2339/ZSP/538/19, të lëshuar me:25.11.2019.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet administrative dhe mjedisore dhe merr **Vendim për vazhdimin e Lejes Mjedisore.**

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës Suharekë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së